



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

D.P.SH Eagle
Valdet Bruti
Drejtor
Prizren

Ankesa Nr. 2012/16-KPM vs D.P.SH EAGLE
Ref: 1301/011/KPM/a.s.

VENDIM

Lidhur me Ankesën nr. 2012/16-Komisioni i Pavarur për Media (KPM) kundër D.P.SH. Eagle (“Pala Përgjegjëse”)

Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM) më datën 5 gusht 2008, ka vendosur që Palës Përgjegjëse t'i lëshoj licencën për të operuar si operator kabllor në Komunën e Prizrenit.
2. KPM me 6 korrik 2007, ka nxjerrë Rregulloren për Distribimin Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë CIMC-2007/04, për rregullimin e operatorëve kabllor dhe ofruesve të shërbimeve programore që veprojnë në territorin e Republikës së Kosovës.
3. Po ashtu me datën 5 gusht 2008, Pala Përgjegjëse ka nënshkruar Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës. Më marrjen e Licencës Pala Përgjegjëse është obliguar që të respektojë të gjitha aktet nënligjore të KPM-së, përfshi ketu edhe Rregulloren për Distribimin Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë CIMC-2007/04.
4. KPM-ja me datën 3 prill 2012, ka bërë monitorimin e Palës Përgjegjëse për të vlerësuar pajtueshmërinë me Rregulloren për Distribimin Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë CIMC-2007/04, dhe në bazë të këtij monitorimi, ka gjetur se gjatë kësaj periudhe Pala Përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 2. paragrafi 2.1.3 të Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, pasi që ka ri-transmetuar kanale pa të drejtë autoriale.
5. KPM bazuar në shkeljen e Kushteve dhe Termet e Përgjithshme të Licencës nga ana e Palës Përgjegjëse, me datën 4 prill 2012, i ka dërguar Njoftim për Shkelje me të cilin nga Pala Përgjegjëse është kërkuar të veprojë në pajtueshmëri me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, në të kundërtën KPM-ja në bazë të Ligjit të KPM-së, do të ndërmer masa ligjore ndaj Palës Përgjegjëse.
6. KPM-ja edhe pas dërgimit të Njoftimit për Shkelje, sërish me datën 22 tetor 2012, ka bërë monitorimin e Palës Përgjegjëse për të vlerësuar pajtueshmërinë me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, dhe në bazë të monitorimit KPM ka gjetur se Pala Përgjegjëse edhe përkundër Njoftimit për Shkelje të datës 4 prill 2012, ka vazhduar të veprojë në kundërshtim me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, duke ritransmetuar 16 kanale pa të drejtë

autoriale: Glob, 21 Plus, Living, TV 2, MTV Kosova, RTS 2, NTV, TOP Channel, Star, ATV, Fox Turk, S Evropa, Tring History, Kanal D, Euro Neës, Samanyolu TV, duke vazhduar të veprojë në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 2.1.3, të Kushteve dhe Termet e Përgjithshme të Licencës.

7. KPM-ja bazuar në shkeljet e vazhdueshme të Kushteve dhe Termet e Përgjithshme të Licencës nga ana e Palës Përgjegjëse, me datën 24 tetor 2012 ka kërkuar nga ana e Palës Përgjegjëse që brenda afatit prej 5 ditëve t'i sjelle kopjet e kontratave që dëshmojnë se Pala Përgjegjëse ka të drejtë t'i ritransmetojë kanalet e sipërshënuara. Edhe pas këtij afati Pala Përgjegjëse ka dështuar t'i sjell kopjet e kontratave.
8. KPM-ja bazuar në shkeljet e vazhdueshme nga ana e Palës Përgjegjëse me datën 5 nëntor 2012, i ka dërguar Vërejtje për shkelje të nenit 2.1.3. të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, dhe ka kërkuar që Pala Përgjegjëse të veprojë në pajtueshmëri të plotë me obligimet ligjore, në të kundërtën KPM në bazë të nenit 30 të Ligjit të KPM-së, do të ndërmerren masa ligjore ndaj Palës Përgjegjëse.
9. KPM-ja edhe pas Vërejtjes se dërguar ka vazhduar me monitorimin e Palës Përgjegjëse, ku me datën 21 nëntor 2012 ka gjetur se ky operator edhe përkundër Vërejtjes ka vazhduar të veprojë në kundërshtim me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës duke ri-transmetuar 14 kanale pa kontrata për ri-transmetim. duke vepruar në kundërshtim me nenin 2, paragrafi 2.1.3, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.

Analiza Ligjore

10. Komisioni bazuar në faktet e sipërshënuara konkludon se Pala Përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 2.1.3 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.

Neni 2 paragrafi 2.1.3 i Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës përcakton:

“I licencuari nuk do të ri-transmetojë asnjë program pa marrëveshje valide mbi të drejtën autoriale. Bartja e kanaleve të programeve pa të drejtën autoriale përbën shkelje të rëndë të Kushteve dhe Termeve të Licencës dhe shkeljet e tilla rezultojnë me revokim të Licencës”.

11. Komisioni duke u bazuar në raportet e monitorimit gjen se Pala Përgjegjëse ka dështuar që të marr hapat e nevojshme për të vepruar në pajtueshmëri me nenin 2, paragrafi 2.1.3, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, pasi që në mënyrë të vazhdueshme ka bërë ritransmetimin e kanaleve pa të drejtë autoriale.
12. Komisioni bazuar në raportet e monitorimit ka gjetur se Pala Përgjegjëse edhe përkundër Njoftimit për Shkelje dhe Vërejtjes përmes të cilave i është bërë me dije se është në shkelje të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, Pala Përgjegjëse ka vazhduar të ritransmetojë kanale pa të drejtë autoriale.
13. Komisioni konstaton se Pala Përgjegjëse nuk ka ndërmarrë asnjë veprim në drejtim të respektimit të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, prandaj KPM si rrethana rënduese për Palën Përgjegjëse ka marr shkeljet e vazhdueshëm dhe pas kërkesave të KPM-së për të vepruar në pajtueshmëri me Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës si dhe Vendimet sanksionuese të datës 1 shtator 2008 dhe atë të datës 5 janar 2009.

Vendim

14. Bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e sipërshënuara, Komisioni gjen se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 2, paragrafi 2.1.3, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.

15. Komisioni konstaton se Pala Përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 2.1.3, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, pasi që në mënyrë të vazhdueshme përmes platformës kabllore ritransmeton kanale pa të drejtë për ri-transmetim.
16. Komisioni bazuar në nenin 30 pika 1.3 të Ligjit të KPM-së, vendos që Palës Përgjegjëse t'i shqiptojë dënimin me gjobë në shumë prej 45,000.00 (dyzet e pesë) mije euro për ritransmetimin e kanaleve pa marrveshje valide, që është në kundërshtim, me nenin 2, paragrafi 2.1.3, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës. Pala Përgjegjëse gjithashtu obligohet që të bëjë ndërprerjen e menjëhershme të ritransmetimit të kanaleve pa të drejtë për ritransmetim në mënyrë që të veprojnë në pajtim me nenin 2, paragrafi 2.1.3, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.
17. Në rast se Pala Përgjegjëse edhe pas pranimit të këtij vendimi vazhdon të veprojë në kundërshtim me Kushtet dhe Tërmete të Përgjithshme të Licencës, Komisioni do të ndërmarrë masa tjera sanksionuese ndaj Palës Përgjegjëse, në pajtueshmëri me nenin 30 të Ligjit të KPM-së.
18. Ky vendim bëhet i plotfuqishëm në momentin e pranimit nga ana e Palës Përgjegjëse. Ankesa kundër këtij vendimi nuk e ndalon ekzekutimin e tij sipas nenit 30 paragrafi 2 pika 2 të Ligjit të KPM-së.

E drejta për Ankesë

19. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkojnë nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42 paragrafi 2 të ligjit të KPM-së.
20. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.
21. Bordi për Ankesa mundet që pa dëgjim të hedh poshtë ankesat të cilat nuk janë të bazuara në njërin nga këto dy mundësi, apo të cilat, nën dispozitat e vendosura nga Bordi për Ankesa në pajtueshmëri me paragrafin 2 të nenit 42 të këtij ligji janë të papranueshme sepse janë të pa vlera keqdashëse apo të pabaza.

Lëshimi i Vendimit


Komisioni e lëshon këtë vendim


Shefki Ukaj

Kryetar

Komisioni i Pavarur për Media




28.12.2012
datë